



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 106/1 prot.

Shkodër më 11.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 1, datë 29.01.2025 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja “n”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, i ndryshuar, shqyrtoi *Vendimin Nr. 1, datë 29.01.2025 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës “Për miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar 6% për ndihmën ekonomike”.*

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 01. Date 29/01 /2025

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Në ligjin Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

KESHILLI BASHKIAK :

V E N D O S I

1. Të miratohen Kriteret Specifike për vitin 2025 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.
 1. Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme,që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
 2. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me aftësi të kufizuar/invalid pune.
 3. Familje me shumë fëmijë.
 4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme,dhe me probleme sociale.
 5. Persona qe jetojnë te vetëm ,të moshuar, që kanë dhe probleme shendetesore .
 6. Familje me te ardhura te pamjaftueshme që ka në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
 7. Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.
 8. Familje që kanë në përbërje të moshuar, që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
 9. Kryefamiljare gra të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme.

- Dokumentat e aplikuesve janë sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
3. Masa e ndihmës ekonomike llogaritet sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
 4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Fuqizimit Ekonomik.
 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Fuqizimit Ekonomik.
Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike sipas përcaktimit të nenit 55 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"



SEKRETARI I KESHILLIT
Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me.....18.....vota
Vota pro ..18.
Vota kunder
Vota Abstenim
Zbardhur me date 03.02.2025

KRYETARI I KESHILLIT
Ervis SHIMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT DHE SPORTIT
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAK

PROJEKT - VENDIM

Nr. 2 datë 16.01.2025

PËR

**“KRITERET PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË
EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% TË FONDIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE”**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Në ligjin Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përlutimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

V E N D O S I

1. Të miratohen Kriteret Specifike për vitin 2025 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.
 1. Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
 2. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me aftësi të kufizuar/invalid pune.
 3. Familje me shumë fëmijë.
 4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme, dhe me probleme sociale.
 5. Persona qe jetojnë te vetëm ,të moshuar, që kanë dhe probleme shendetesore .
 6. Familje me te ardhura te pamjaftueshme që ka në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
 7. Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.

8. Familje që kanë në përbërje të moshuar, që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
9. Kryefamiljare gra të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.
2. Dokumentat e aplikuesve janë sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
3. Masa e ndihmës ekonomike llogaritet sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Fuqizimit Ekonomik.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Konceptoi:

Përgjegjës/ Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Pak

Eraldo Geci

Konfirmoi bazën Ligjore:

Drejtorja Juridike:

Eraldo Geci